

**AKTI I THEMELIMIT TË SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR "AGROAL MIKRO-ELEMENT" SH.P.K.**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME
NENI 1**

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, sot, **me dt. 10/02/2022** me vullnet të lirë, Ortaku i vetem:

1. **Alfonc Pilinci**, lindur më 12.04.1957, në Shqipëri, banues në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetas Amerikan, pajisur me pasaportën me nr. 587754058;

si themelues i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosi të hartojë këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

**NENI 2
EMRI**

Emri i shoqërisë është "Agroal mikro-element" shpk.

**NENI 3
FORMA**

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakut do të përballojë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara për kapitalin.


**NENI 4
SELIA**

Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Rruga "Koli Bano", Pallati 28, Shkalla 1 Ap. 3, Tiranë, Shqipëri.

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 5
KOHËZGJATJA**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.


1

NENI 6 O B J E K T I

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Shoqëria ka për objekt kryerjen e çdo aktiviteti tregtar në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi. Në veçanti, shoqëria mund të kryejë këto shërbime: Tregtim me shumicë dhe pakicë, të plehrave kimike të pesticideve si dhe të çdo produkti tjetër për mbrojtjen e bimëve, tokës dhe farave. Tregtim me shumicë dhe pakicë të farërave dhe fidaneve, mbjellje fidanesh, tregti me shumicë dhe pakicë veglash bujqësore, etj. Import-eksport, transport mallrash brenda e jashtë vendit për llogari të subjektit si dhe kryerjen e çdo aktiviteti të lejuar nga ligji që lidhet direkt ose indirekt me objektin e veprimtarisë.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë i ndarë në një pjesë.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara dhe nënshkruar si më poshtë:

- 1. Z. Alfons Piliñci** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100% të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabartë me vlerë prej 100,000 (njëqinde mijë) lekë në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar i shoqërisë do të shlyhet teresisht brenda 1 (një) muaji nga themelimi i shoqërisë dhe do të depozitohet në një llogari bankare të hapur në emër të Shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dytë.


Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 8 ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Shoqëria mund të emerojë më shumë se një administrator. Veprimet e të cilëve do të jenë njëjloj të vlefshme si kur meren bashkërisht ashtu edhe kur meren veç e veç. Në



cdo rast, kur termi 'Administrator' perdoret per te percaktuar administratoret e shoqerise 'Agroal mikro-element' sh.p.k. ky term nenkupton te gjithe administratoret e saj, sado qofshin keta ne numer.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese do te rregullohet sipas ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare" i ndryshuar dhe Statutin e shoqerise.

NENI 9

ORGANI ADMINISTRATIV

Administrator i parë i shoqërisë per nje periudhe 3 (tre) vjecare eshte emeruar **Z. Agim Barci**, shtetas shqiptar, pajisur me leternjoftimin me nr. 034992640 dhe nr. Personal identifikimi F51205109G.

NENI 10

DISPOZITAT E FUNDIT

Ky akt themelimi eshte hartuar ne 3 (tre) kopje te njejta ne gjuhen shqipe, duke patur secila kopje fuqi te njejte ligjore.

THEMELUES

Alfonc Pilinci

ALFONC PILINCI
Alfonc Pilinci